



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIC OF KOSOVO
MUNICIPALITY OF LIPJAN
07.08.18
1-463-40755



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PËRKOHSHËM TË LOKALIT AFARIST NË PRONËSI TË KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 22 nëntor 2012, nenit 10 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe dispozitave të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 10 maj 2012, me datë 31.07.2018, lidhet kjo kontratë ndërmjet palëve kontraktuese:

1. Komuna e Lipjanit, të cilën e përfaqëson z.Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, në vazhdim të tekstit Qiradhënësi, dhe
2. Subjekti politik-Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, e përfaqësuar nga Fehmi Rexhepi me nr.personal 1030393674, në vazhdim të tekstit Qiramarrësi

Neni 1

Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim të përkohshëm të lokalit afarist me sipërfaqe prej 58.91m², bodrum, pjesa very-lindore, rr"Lidhja e Prizrenit" në Lipjan, i cili gjendet në kuadër të kompleksit NTP"Dino", ngastra kadastrale O-71409044-01926-0-23-4-16-0 pronë e Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Kohëzgjatja e Kontratës

Qiradhënësi dhe Qiramarrësi janë pajtuar që lokali i cekur në nenin 1 të kësaj kontrate të ipet-mirret në shfrytëzim të përkohshëm në kohëzgjatje prej 10 vitesh duke filluar nga data 30.07.2018 deri me datë 30.07.2028.

Pas përfundimit të kësaj periudhe për vazhdimin e shfrytëzimit duhet të zhvillohet procedurë e re e ankandit publik.

Neni 3

Lartësia e qirasë

1. Qiramarrësi obligohet që në emër të shfrytëzimit të lokalit ta paguaj qiranë vjetore në shumën e përgjithshme prej 388.80€ (treqind e tetëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent).
2. Shuma e përgjithshme që duhet paguar është llogaritur si vijon: 0.55 euro për m² shumëzuar me sipërfaqen e lokalit afarist prej 58.91m² gjithsejtë 32.40 € (tridhjetë e dy euro e katërdhjetë cent), shumëzuar me 12 muajt e vitit kalendarik (0.55x58.91=32.40x12=388.80 € (treqind e tetëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent).

Neni 4

Afati i pagesës

1. Qiramarrësi obligohet që pagesën e shumës së qirasë ta bëjë në afat prej 10 (dhjetë) kësteve të barabarta në bazë vjetore si në vijim:
 - 1.1. Këstin e parë (1) do ta paguaj në ditën e nënshkrimit të kontratës,
 - 1.2. Nëntë (9) këstet e tjera më së largu deri me datën 5 të muajit Gusht të çdo viti kalendarik,
2. Pagesat bëhen në xhirollogarinë e Komunës Nr. 1000650150000190 destinimi: pagesa e qirasë për shfrytëzimin e lokalit afarist.

Neni 5

Dorëzimi i lokalit qiramarrësit

Zyra e Kryetarit-sektori pronëso- juridik obligohet që brenda afatit prej 5 ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës, t'ia dorëzojë me procesverbal qiramarrësit lokalit në shfrytëzim, siç ceket në nenin 1 të kësaj kontrate.

Neni 6

Mënyra e shfrytëzimit

Qiramarrësi lokalit afarist mund ta shfrytëzojë vetëm për ushtrimin e aktiviteteve politike, duhet ta shfrytëzojë tërë hapësirën prej 140m² vetëm për një lokal dhe nuk mund të ndan nënlokale dhe të jep në shfrytëzim personave të tjerë, nuk mund ta bartë në personat e tretë, njëkohësisht nuk mund ta ngarkojë lokalit me peng apo me hipotekë.

Neni 7

Obligimet e qiradhënësit

1. Qiradhënësi me këtë kontratë është i obliguar që t'i mundësojë qiramarrësit shfrytëzimin e lokalit afarist pa pengesa nga pretendimet e mundshme të personave fizik dhe juridik.
2. Qiradhënësi nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate nuk merr asnjë përgjegjësi për obligimet e qiramarrësit lidhur me energjinë elektrike, furnizimit me ujë, gaz, mbeturinave dhe ndonjë obligim tjetër që mund të rezulton nga shfrytëzimi i lokalit.

Neni 8

Obligimet e qiramarrësit

1. Qiramarrësi është i obliguar ta shfrytëzoj lokalit në mënyrën e caktuar në nenin 6 të kontratës.
2. Qiramarrësi obligohet që ta paguajë qiranë vjetore ashtu siç përcaktohet në nenin 4 të kontratës, po ashtu nga momenti i dorëzimit të lokalit në posedim duhet ti paguaj të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e lokalit, të energjisë elektrike ato të furnizimit më ujë, gaz, të bartjes së mbeturinave dhe shpenzimet e tjera lidhur me shfrytëzimin e lokalit, ndërsa obligimet-borxhet e akumuluar deri në dorëzimin e lokalit në posedim mbesin përgjegjësi e Komunës.

Neni 9

Shkëputja e kontratës

1. Palët kontraktuese mundën në çdo kohë me marrëveshje të bëjnë shkëputjen e kësaj kontrate, me ç'rast duhet të përpilojnë akte me shkrim.
2. Para shkëputjes së kontratës palët kontraktuese duhet që t'i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me obligimet reciproke në pajtim me dispozitat e saj.

Neni 10

Shkëputja e njëanshme e kontratës nga Qiradhënësi

Qiradhënësi ka të drejtë ta shkëputë kontratën në rastet si në vijim:

1. Kur qiramarrësi i lokalit nuk i paguan këstet e qirasë ashtu siç është përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontrate dhe pas lëshimit me shkrim të dy(2) vërejtjeve paraprake nga Qiradhënësi.
2. Nëse nga ana e Drejtoratit për Inspektion vërtetohet se qiramarrësi ka ndryshuar mënyrën e shfrytëzimit e cekur në nenin 6 të kontratës.
3. Qiradhënësi ruan të drejtën që në mënyrë të njëanshme të bënë shkëputjen e kësaj kontrate edhe para afatit 10 vjeçar por do të ketë parasysh afatin e pagesës për të njëjtin vit, me rastin e ndërprerjes së kontratës në çfarëdo mënyre qiramarrësi ka për obligim që lokalit ta dorëzojë në gjendje të rregullt ashtu siç ka qenë me rastin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 11

Shkëputja e njëanshme e kontratës nga Qiramarrësi

1. Qiramarrësi mund ta shkëputë kontratën në mënyrë të njëanshme nëse Qiradhënësi nuk i përmbushë obligimet e përcaktuara në nenin 7 të kësaj kontrate.
2. Me heqjen dorë nga shfrytëzimi i mëtejshëm i lokalit duke njoftuar me shkrim për këtë Qiradhënësin në afat paraprak prej 30 ditësh para datës prej së cilës qiramarrësi nuk dëshiron ta shfrytëzojë lokalit.
3. Para bërjes së njoftimit për shkëputjen e njëanshme të kontratës, qiramarrësi duhet ti përmbushë obligimet e mbetura në pajtim me dispozitat e kontratës dhe të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 12

Aplikimi i dispozitave ligjore dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët janë pajtuar që për çështjet që nuk janë rregulluar më këtë kontratë, të cilat paraqiten gjatë zbatimit të kontratës do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 22 maj 2012.
2. Në rastin e mosarritjes së marrëveshjes në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni për zgjidhjen e kontestit për zbatimin e dispozitave të kësaj kontrate, palët do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 13

Zbatimimi i kontratës

1. Për zbatimin në tërësi të kësaj kontrate do të kujdeset Zyra e kryetarit-sektori pronëso-
juridik.
2. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim është i obliguar të njoftojë Sektorin pronëso-
juridik për pagesat e shfrytëzimit të lokalit afarist.
3. Drejtorati i Inspektoratit do ta mbikëqyrë zbatimin e kësaj kontrate sipas nenit 6 dhe për këtë
do të njoftojë Sektorin pronëso-
juridik.
4. Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi në bazë të kësaj kontrate do të evidentojë të drejtën e
shfrytëzimit në emër të Qiramarrësit konform neneve 1 dhe 2 të kësaj kontrate dhe për këtë do të
njoftojë Sektorin pronëso-
juridik.

Neni 14


Hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë është përpiluar në ekzemplarë të mjaftushëm, ku nga një ekzemplarë e
marrin palët kontraktuse, ndërsa ekzemplarë e tjerë mbesin në organet përkatëse komunale të
cilat bëjnë zbatimin e saj.
2. Kontrata hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kontraktuesit.

NËNSHKRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

Subjekti politik-Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI) me seli në Lipjan, e përfaqësuar nga
Fehmi Rexhepi me nr.personal 1030393674, në vazhdim të tekstit Qiramarrësi



 z.Imri Ahmeti, Kryetar i Komnës-Qiradhënësi